



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISE
KRYESIA

Nr. 80 prot.

Puke, 16.01.2025

Procesverbal i mbledhjes se kryesise se keshillit , i mbajtur sot me date 16.01.2025 :
Te njoftuar per mbledhje :

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Besar Kuçi
5. Alfons Gjergj
6. Hazbi Terbuni

Moren pjese:

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Besar Kuçi
5. Alfons Gjergj
6. Hazbi Terbuni

Tematika e mbledhjes eshte : Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së rradhës të Këshillit Bashkiak” per muajin Janar 2025

Mbledhjen e hap kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka, i cili prezantoi projekt-rendin e dites te pergatitur paraprakisht ne bashkepunim me kryetarin e Bashkise dhe administraten e bashkise si me poshte vijon:

Ne perfundim te mbledhjes kryesia , pas diskutimit te anetareve vendosi te miratoje te gjitha pikat e projekt-rendit te dites dhe mori Vendimin nr.6 date 16.01.2025, ku u percaktua data dhe ora e zhvillimit te mbledhjes se keshillit, detyrat per sekretarin e keshillit per berjen publike te njoftimit dhe dergimin e materialeve te pergatitura per mbledhjen e keshillit , sipas rendit te dites se miratuar. Po keshtu u percaktua dhe data dhe ora e mbledhjes se komisioneve te perhereshme te keshillit, sipas shenimit te lartpermendur.

1. Per miratimin e dhenies se mandatit te Zj. Leze Ndrek Kolaj.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 27.12.2024
3. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Dhjetor 2024**.

4. Projekt-vendim “ Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026”
5. Projekt-vendim “ Per miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Pukë , njësisive administrative , Institucioneve të vartësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025”
6. 6. Rishqyrtim i VKB nr. 55 datë 03.12.2024 “ “ Për miratimin e planit të mbarshimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Gomsiqe në NJA Qerret, Pukë, të Bashkisë Pukë”
7. Projekt-vendim “ Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri 6% te fondit”
8. Të tjera.

Shënim: Mbledhjet e komisioneve të përherëshme të këshillit zhvillohen më datë 21. 01 .2025 , nga ora 13⁰⁰ deri ne oren 16⁰⁰ në zyrën e sekretarit të këshillit.

Kryetari I keshillit
Gjon Gjoka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Nr. 80/1 prot.

Puke, me 16.01.2025

VENDIM

Nr. 6 datë 16 .01 .2025

“Për miratimin e rendit të ditës të mbledhjes së rradhës së Këshillit Bashkiak”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr.14 datë 30/06/2020, neni 57, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 16. 01. 2025;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 22. 01. 2025, ora 13³⁰.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit të rendit të ditës, si dhe dosjen me materialet e mbledhjes tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Gjon Gjoka

